



01 Nr. 660/24 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të krijuara rreth pritjes zyrtare të delegacionit nga Qyteti i Bursës-Komuna Orhangazi e Republikës së Turqisë, të cilët do ta vizitojnë Komunën e Prizrenit nga data 25 tetor 2024 deri me 27 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të akomodimit, ushqimit, dhe shpenzimeve tjera të paparashikuara, rreth pritjes së këtij delegacioni, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Qëllimi i vizitës zyrtare të këtij delegacioni është fillimi i bashkëpunimit mes të Komunës së Prizrenit dhe Komunës Orhangazi në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit, etj.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jenë faturat përkatëse.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Zyrës së Kryetarit,
 - Arkivës së Kryetarit.